

V E N D I M
Nr.4, datë 2.6.1995

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani,	Zv/kryetar i “““
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Manol Konomi,	Anëtar i “““
Veli Budo,	Anëtar i “““
Franc Jakova,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Metush Saraçi,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, më datat 19.5.1995, 22.5.1995, 24.5.1995 dhe 2.6.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me nismën e saj, çështjen nr.6 Akti, me

O B J E K T

“Interpretimi i nenit 18 paragrafi i tretë i ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese” në lidhje me ripërtëritjen e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese”.

GJYKATA KUSHTETUESE ,

pasi dëgjo i relacionin përkatës,

V Ë R E N :

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka bërë betimin para Presidentit të Republikës në datën 19 maj 1992 dhe ka filluar nga funksionet e saj më 1 qershor 1992.

Në janar të vitit 1995 kanë filluar punën në Gjykatën Kushtetuese, tre anëtarë të rinj, të caktuar sipas përkatësisë në vend të tre anëtarëve që kishin dhënë dorëheqjen nga detyra.

Sipas nenit 18, paragrafi i tretë i ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Afati i tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të caktuar në zgjedhjen e parë mbaron në krye të tre vjetëve. Emrat

e tyre caktohen me short, në secilin grup gjyqtarësh të zgjedhur nga Kuvendi Popullor dhe nga Presidenti i Republikës. Pas tre vjetëve të tjerë zëvendësohen në të njëjtën mënyrë, me short, nga tre gjyqtarë të tjerë. Gjyqtarët zëvendësohen qëndrojnë në detyrë 12 vjet, pa të drejtë rizgjedhje”.

Siç shihet, kjo dispozitë parashikon ripërtëritjen graduale të Gjykatës Kushtetuese, duke ruajtur gjithmonë në përbërje shumicën prej 2/3 e anëtarëve me stazh në detyrë në Gjykatë. Ky është një parim organizativ, i pranuar edhe në dispozita kushtetuese të vendeve të tjera, nisur nga veçoritë specifike të procesit gjyqësor kushtetues i cili përveç njohurive kërkon dhe përvojën e duhur.

Hedhja e shortit vetëm në fund të afatit të parë e të dytë trevjeçar të Gjykatës është një rregull proceduror parashikuar nga ligjvënësi për zëvendësimin gradual të anëtarëve të zgjedhur në fillimin e veprimtarisë së Gjykatës, për të arritur në zëvendësimin periodik në mbarim të çdo mandati. Në këtë mënyrë realizohet qëllimi i ligjvënësit që gjithmonë në përbërje të Gjykatës do të jenë 2/3 e anëtarëve me stazh në detyrë jo më pak se tre vjet.

Nga sa u tha më lart, Gjykata arrin në përfundim se me ardhjen e tre anëtarëve të rinj disa muaj para mbarimit të afatit të parë trevjeçar, qëllimi i ligjit për ripërtëritjen graduale të Gjykatës çdo tre vjet është arritur plotësisht, duke mos qenë e nevojshme në këtë rast që të hidhet shorti.

Po të pranohej një interpretim i kundërt dhe të hidhej shorti, do të shkaktohej që të ripërtërihej, brenda muajve të fundit të të njëjtit trevjeçar, jo 1/3 por 2/3 e përbërjes së Gjykatës, domethënë do të zëvendësoheshin njëherësh gjashtë gjyqtarë kushtetues, çka nuk pajtohet me qëllimin e ligjit dhe do të dëmtonte cilësinë e dhënies së drejtësisë kushtetuese.

Megjithëse ky interpretim ka për objekt ripërtëritjen e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, ai kryhet nga vetë kjo Gjykatë, sepse paketa e ligjeve tona kushtetuese nuk ia le këtë kompetencë edhe ndonjë organi tjetër. Rrjedhimisht, gjersa interpretimi i ligjeve kushtetuese është prerogativë vetëm e kësaj Gjykate, nuk ka në rastin konkret asnjë shkelje të parimit se askush nuk mund të jetë gjyqtar në çështjen gjyqësore të vetë. (“Nemo iudex in causa sua”)

PËR KËTO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 pika 1, 25 e 26 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” me shumicë votash,

V E N D O S I:

Ripërtëritja e përbërjes të Gjykatës Kushtetuese është bërë, rrjedhimisht nuk ka vend për hedhjen e shortit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, dhe hyn në fuqi menjëherë.

Votuan kundër këtij vendimi : Hilmi Dakli, Manol Konomi e Metush Saraçi.

MENDIMI I PAKICES

Nuk mund të bashkohemi me pikëpamjen e shumicës në lidhje me interpretimin e nenit 18, paragrafi i tretë.

1. Paragrafi i fundit i këtij neni shtron parimin se Gjykata Kushtetuese, me mbarimin e afatit të parë dhe të dytë trevjeçar, duhet të ndryshohet në përbërjen e saj në një të tretën. Në një kohë kjo dispozitë shtron rregullin me përmbajtje precize se mandati i tre gjyqtarëve të kësaj Gjykate mbaron në krye të tre vjetëve dhe emrat e tyre caktohen me short.

2. Sistemi që parashikon neni 18, paragrafi i tretë, për ndryshimet që duhet të bëhen në përbërjen e Gjykatës Kushtetuese, është i qartë dhe koherent. Për pasojë, nuk lihet asnjë hapësirë e mundshme për interpretimin e kësaj norme në mënyrën që është vendosur nga shumica.

3. Ligji ka parasysh ndryshimet që duhet të bëhen detyrimisht dhe me qëllim natyrisht përtëritje, me plotësimin e afateve që ky ligj cakton dhe jo ndryshimet që mund t’i vijnë Gjykatës për shkak që parashikohen nga neni 23 ose dhe për shkaqe të tjera.

4. Me zëvendësimin e tre gjyqtarëve të larguar, para mbarimit të trevjeçarit të parë, me tre gjyqtarë të rinj nuk mund të arrihet në konkluzion se përtëritja e Gjykatës dhe si rrjedhim dhe hedhja e shortit është tanimë e panevojshme për arsye se u arrit qëllimi i ligjvënësit: përtëritja e Gjykatës në një të tretën. Këtu duhet shtuar se gjyqtarët e rinj kanë zënë vendin (për të gjitha efektet e ligjit duke përfshirë edhe zbatimin e nenit 18, paragrafi i tretë) e gjyqtarëve të larguar, gjë që del e qartë edhe nga përmbajtja e nenit 23, paragrafi i fundit.

5. Ndryshimet (në masë dhe në kohë) që mund të pësojë Gjykata gjatë ushtrimit të funksionit të saj (mandatit) janë të shumta, por ato nuk kanë karakterin e përtëritjes në kuptimin e normës të nenit 18 dhe nuk mund të përdoren si argumente në favor ose kundër të njëres pikëpamje ose tjetres.

6. Gjykata Kushtetuese, brenda kuadrit të detyrës së vet për interpretimin e normave kushtetuese, mund të nxjerrë të gjitha rrjedhimet e mundshme, por nuk mund të kalojë në një interpretim shumë të gjerë, sepse në këtë rast do t’i atribuonte vetes funksione legjislativë.

Tiranë, më 2.6.1995